



Maj 2020

POSTA AJRORE



Mesazh i Znj. Edlira Kraja
Drejtor Ekzekutiv


Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar përballë sfidave të COVID-19

Pas një eksperience prej 17 vjetësh në strukturat e Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar sot gjendem e nderuar t'ju përshëndes të gjithëve në pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv të këtij institucioni.

Gjithmonë kam besuar se puna, përpjekjet, besimi janë faktorët kontribues të realizimeve kyçe për njeriun. Së bashku me stafin ndihemi njëherazi të privilegjuar dhe plot përgjegjësi në përmbyshje të misionit për të ofruar shërbime efikase, të sigurta dhe të parrezikshme në transportin ajror.

Viti 2020 do të mbahet mend si Viti i COVID-19, i vështirësive dhe sfidave që ai solli për të gjithë ne. Përgjatë këtyre muajve, transporti ajror në mbarë botën është përballur me sfidën më të madhe të historisë së tij. Situata e jashtëzakonshme rezultoi jo vetëm në uljen drastike të fluturimeve, por edhe të të gjitha shërbimeve të tjera të lidhura. Në të gjithë Evropën numri i fluturimeve ra në një mesatare rreth 87,2%. Fluturimet ditore ranë në 3949 në periudhën Prill-Maj, e cila arriti pikun në 12 prill 2020, me -92,8%.

Transporti ajror në vendin tonë gjithashtu po përjeton një situatë kritike. Periudha Janar-Maj 2020 shënon rreth 243 fluturime ditore (përfshirë dhe mbikalimet). Një shifër kjo është rreth 47,1 % më e ulët se e njëjta periudhë e vitit 2019. Kriza e shkaktuar nga COVID-19 u shfaq ndjeshëm në vendin tonë përgjatë muajve Prill-Maj, ku numri i fluturimeve ditore arriti 59 (IFR) ose rreth 89,9% më e ulët se e njëjta periudhë e vitit 2019. Përgjatë këtyre muajve Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka dhënë gjithë mbështetjen e nevojshme për menaxhimin e sigurt të fluturimeve të riatdhesimit të shtetasve shqiptarë.



Mbledhja e 154 e Drejtorëve të Përgjithshëm të Aviacionit Civil

Përmes video konferencës me datë 20 Maj 2020, Drejtorët e Përgjithshëm të Aviacionit Civil të 44 Shteteve Anëtare të ECAC ku bënë pjesë dhe Shqipëria e përfaqësuar nga Znj. Edlira Kraja Drejtor Ekzekutiv e AAC dhe përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare të sektorit të transportit ajror si ICAO, EASA, EUROCONTROL diskutuan mbi çështjet e rendit të ditës dhe morën vendime në lidhje me:

- Pranimin anëtar të rinj të Komitetit të Koordinimit të ECAC të Znj. Rannia Leontardi (DGCA UK) dhe Z. Piotr Samson (DGCA Poland);
- Vazhdimin e punës për implementimin e Marrëveshjes midis ECAC dhe EUROCONTROL;
- Mandatimin e Presidentit dhe Sekretarit Ekzekutiv që të kërkojnë amendimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit ICAO-ECAC të vitit 2006, për ndarjen e shpenzimeve për Zyrën Rajonale të EuroAtlantikut (ICAO EUR/NAT Regional Office) dhe çështje të tjera ligjore dhe administrative;
- Drejtorët e Përgjithshëm mirëpritën propozimin për themelimin e një "fondi solidariteti" për mbështetjen e Shteteve Anëtare që po ballafaqohen me sfidat për shkak të krizës së COVID-19. Ata u njoftuan se këto propozime do të paraqiten në takimin e radhës tjetër të Komitetit të Koordinimit për vlerësime të mëtejshme dhe diskutime.

Mbledhja e 155të e Drejtorëve të Përgjithshëm të Administratave të Aviacionit Civil të ECAC (DGCA/155) është parashikuar të mbahet më datë 10 dhjetor 2020, në Paris, Francë.

Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar përballë sfidave të COVID-19

Mesazh i Znj. Edlira Kraja
Drejtor Ekzekutiv

Me misionin për t'ju përgjigjur dhe përmbushur çdo kërkesë të qytetarëve tanë për riatdhesim ne u bëmë pjesë e jetëve të tyre, e shqetësimit të ndarjes dhe gëzimit të bashkimit, për të kuptuar dhe njëherë se aviacioni nuk është vetëm një pjesë e rendësishme e ekonomisë shqiptare, por njëherazi dhe një mënyrë e shpejtë dhe e sigurt për të qënë pranë njerëzve të dashur.

Tashmë ne besojmë se ringritja është e mundur, nisur kjo edhe nga përvoja e gjatë që ka aviacioni në fushën e menaxhimit të rrezikut dhe sigurisë. Rregullatori, së bashku me ofruesit e shërbimeve në këtë sektor, po bashkëveprojnë për një rimëkëmbje sa më të shpejtë të industrisë dhe rikthimin e besimit të pasagjerëve dhe publikut në përgjithësi për një udhëtimin ajror të sigurt. Me qëllim rifillimin e fluturimeve dhe rikthimin sa më shpejt të normalitetit, AAC po bashkëpunon me të gjitha palët e përfshira në aviacionin civil si dhe ato të shëndetësisë për marrjen e masave dhe monitorimin e tyre në mbrojtje të COVID-19. Në këtë kuadër, rifillimi me sukses i udhëtimeve dhe rivendosja e besimit të pasagjerëve për sigurinë e udhëtimit ajror janë parakushte jetike për të recuperuar sa më shpejt dëmet e shkaktuara nga COVID-19. Ne jemi duke u kujdesur që Aviacioni Civil Shqiptar të jetë i koordinuar me udhëzimet dhe masat e rekomanduara nga institucionet ndërkombëtare. Bashkëpunimi i ngushtë me vendet partnere dhe organizatat ndërkombëtare përfshirë Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) dhe Agjensinë e Sigurisë së Aviacionit të Bashkimit Evropian (EASA) ka qenë thelbësor në këtë drejtim. Aktualisht është përgatitur dhe është informuar industria që operon në vendin tonë për **"Udhëzimin e masave të zbatueshme në mbrojtje të rrezikut të COVID-19"**. Ky dokument përmban udhëzime teknike operationale me qëllim menaxhimit dhe garantimin e sigurisë së shëndetit në aeroport dhe në fluturim. Brenda tij qartazi janë përcaktuar roli dhe përgjegjësitë e secilit prej aktorëve të përfshirë në këtë proces në zbatim të masave mbrojtëse nga rreziku i COVID-19. Me qëllim që të lehtësohen operimet, të tejkalohen pengesat dhe të organizohet në mënyrë sa më efektive puna me masat e nevojshme për rifillimin e sigurt të operimeve dhe aktiviteteve të tjera, AAC është në kontakt me Entin Menaxhues të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, operatorët ajrorë vendas Air Albania dhe Albawings, ofruesin e shërbimeve të lundrimit ajror ALBCONTROL, si dhe entitet të tjera, me të cilët ndahet çdo informacion, eksperiencë apo praktika të mira që na vijnë në formë rekomandimesh dhe udhëzimesh nga ICAO, EASA, EUROCONTROL dhe ECAC.

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm publikimin e çdo informacioni dhe materiali të nevojshëm për ndërgjegjësimin e publikut për nevojën e zbatimit të masave të veçanta për ruajtjen e shëndetit të pasagjerëve dhe personave të tjerë (**motoja: ruaj veten, ruaj shëndetin e të tjerëve**), për të arritur një komunikim sa më të gjerë dhe efektiv midis palëve, me fokus kryesor informimin e pasagjerit, AAC është e angazhuar në publikimin e informacionit të nevojshëm nëpërmjet faqes së saj zyrtare dhe mjeteve të tjera të komunikimit masiv, social.

AAC në përmbushjen e funksionit të saj mbikqyrës mbi të gjitha veprimtaritë e sistemit të transportit ajror civil, ndjek gjithashtu me vëmendje dhe kontrollon në vazhdimësi edhe masat zbatuese për ruajtjen e shëndetit të pasagjerëve dhe punonjëseve të industrisë. Pavarësisht periudhës së pandemisë dhe kufizimeve të detyruara, Inspektorët e Autoritetit, për aq sa e kanë lejuar rrethanat, kanë vazhduar pa ndërprerje aktivitetin e tyre mbikqyrës. Në këtë periudhë janë kryer vizita pune dhe inspektime nga drejtoritë teknike, verifikime të plotësisht të rekomandimeve për korrigjimin e gjetjeve të mëparshme, kontrolle për trajnimet e ofruara nga vet aeroporti për punonjësit e sigurisë, si dhe me operatorët për publikimin e afishimit të këtyre masave në mjediset e aeroportit dhe në kabinën e avionit. Gjithashtu, Autoriteti i Aviacionit Civil, duke besuar se bashkëpunimi është çelësi për të dalë nga kriza dhe për rimëkëmbje sa më të shpejtë, ka zbatuar gjatë kësaj periudhe masa përjashtuese për subjektet e çertifikuara prej tij, duke mirëkuptuar pamundësinë e përmbushjes së disa detyrimeve për shkak të kufizimeve të imponuara nga situata e pandemisë.

Gjatë periudhës 23 mars deri më 28 maj 2020 janë kryer gjithsej 77 fluturime të tilla dhe mbi 5000 shtetas shqiptarë u rikthyen në Shqipëri.



Këtë muaj, si rezultat i masave të ndërmarra në mënyrë të harmonizuar me politikat e udhëzuara nga Ministri i Infrastrukturas dhe Energjisë, jemi në kushtet kur mund të drejtohem në mënyrë të sigurtë drejt një ri-hapje graduale të operimeve ajrore. Krahas fluturimeve të riatdhesimeve, fluturimeve cargo (me artikuj humanitar, mjekësor) dhe atyre emergjente të facilituara së fundmi, shumë shpejtë do të kemi fluturime të rregullta, të koordinuara me vendet partnere të Republikës së Shqipërisë në transportin ajror ndërkombëtar. Rifillimi i fluturimeve do të kryhet siç u përmend nën rregullat e përcaktuara të sigurisë shëndetësore, gjë që siguroshet do të kërkojë një ndërgjegjësim të aeroportit, operatorëve ajrorë dhe pasagjerëve për të përjetësuar këto rregulla dhe për t'i zbatuar ato në mënyrë rigorozë. Një sfidë e shtuar do të jetë kjo për Entin Menaxhues të Aeroportit, i cili duhet të demonstrojë aftësi të mira të menaxhimit të flukseve që do të krijohen në kushtet e orientuara nga udhëzuesi për

masat mbrojtëse ndaj COVID-19.

Në mbyllje dëshiroj të rikonfirmoj se me përkushtim e devotshmëri, së bashku me organizatat dhe industrinë, do ja dalim ti kapërcejmë vështirësitë e shkaktuara nga COVID-19 dhe se shumë shpejtë aviacioni civil do t'i rikthehet edhe më fuqishëm qiellit blu, duke na bërë krenar të gjithëve!


Edlira KRAJA

EUROCONTROL

Fokusi në Shqipëri

Nga Janari deri në Maj, Albcontrol në hapësirën e kontrolluar nga Shqipëria ka pasur një mesatare prej 243 fluturime ditore (duke përfshirë dhe mbikalimet), ose 47,1% më pak se e njëjta periudhë e vitit 2019. Rënia reflekton impaktin masiv të krizës së COVID-19 dhe është më madhe kur fokusi është vetëm në periudhën Prill-Maj me 59 fluturime (IFR) në ditë ose 89,9% më pak se njëjta periudhë e vitit 2019.

Skicat dhe tabelat e mëposhtme paraqesin situatën në nivel Shteti, nivelin e afërimit (ACC) dhe për Aeroportin e TIAs.




AVERAGE NUMBER OF DAILY FLIGHTS - ACC (including overflights)				
ACC	Jan-May 2020	% change vs 2019	April-May 2020	% change vs 2019
Tirana ACC	243	-47.1%	59	-89.9%

AVERAGE NUMBER OF DAILY ARRIVALS				
Airport	Jan-May 2020	% change vs 2019	April-May 2020	% change vs 2019
Tirana	17	-48.3%	3	-92.4%

10 qytetet kryesore (në kuptim të fluturimeve të nisjes/ mbërritjes) në Shqipëri, në Prill-Maj kanë ndryshuar ndjeshëm gjithashtu në krahasim me vitin e kaluar dhe që paraqiten në tabelat e mëposhtme:


DEPARTING/ARRIVING FLIGHTS (Daily Average)			
Top 10 City-pairs (From/To)		April-May 2019	April-May 2020
Tirana	Rome Fiumicino	8.3	1.8
Tirana	Milan Malpensa	5.9	0.5
Tirana	Frankfurt	4.9	0.4
Tirana	Vienna	4.1	0.4
Tirana	Athens	3.9	0.3
Tirana	Bergamo	3.5	0.2
Tirana	Bologna	3.5	0.2
Tirana	Verona	3.5	0.1
Tirana	Istanbul (Grand + Ataturk)	3.5	0.1
Tirana	Pisa	3.4	0.1

Sa për ilustrim, zhvillimi për fluturimet e shkurtra dhe mesatare (<4000km)



nga Aeroporti i Tiranës midis Prill – Maj 2019 dhe 2020 mund të shihet në hartën e mëposhtme:

Zhvillimi i segmenteve të tregut ka pasur ndryshime gjithashtu krahasuar me vitin e kaluar. Për Prill- Maj , gjithë fluturimet kargo llogariten në 40% të mesatares së trafikut për Shqipërinë në 2020 krahasuar me 14% në vitin



2019. Ndarja e skedulës së trafikut, e cila vitin e kaluar llogaritet në 65% është ulur vetëm me 4%.

Tarifa për rrugë

Në emër të Shqipërisë, EUROCONTROL ka faturuar shoqëritë ajrore me 4,2 M Euro për tarifë rrugë në Janar-Prill 2020. Kjo shumë është 29,5% më pak se e njëjta periudhë e vitit 2019 dhe paraqet 0,28% të totalit të tarifës së rrugës të faturuar nga EUROCONTROL.

ROUTE CHARGES 2020 (% vs 2019)					
En-route Charging zone	Jan-20	Feb-20	Mar-20	Apr-20	Total
Albania	14.1%	18.4%	-38.3%	-86.6%	-29.5%

10 shoqëritë kryesore (në kuptim të tarifës së rrugës) të faturuar në emër të Shqipërisë në periudhën Janar deri Prill 2020 mund të gjenden në tabelën e mëposhtme:

ROUTE CHARGES 2020	
Top 10 airlines	M€
Turkish Airlines	0.33
British Airways	0.31
Air France	0.24
Aegean Airlines	0.23
SAUDIA	0.22
Ethiopian Airlines	0.20
EGYPTAIR	0.18
Lufthansa	0.16
SWISS	0.15
easyJet	0.15



Rritja e vazhdueshme e aviacionit gjatë viteve të fundit ka bërë që të rritet edhe kërkesa për përdorimin e hapësirës ajrore në dispozicion, duke theksuar në këtë mënyrë nevojën për shfrytëzimin optimal të saj. Ofrimi i shërbimeve të trafikut ajror duke përdorur konceptin e PBN (Performance Based Navigation), pra lundrimin mbi bazën e performancës, siguron përfitime në termat e sigurisë ajrore, kapaciteteve dhe efikasitetin nëpërmjet optimizimit të rrugëve ajrore dhe afërimit instrumental.

Koncepti i PBN specifikon që kërkesat e performancës për sistemet RNAV dhe RNP të avionëve të përcaktohen në termat e saktësisë, integritetit, disponueshmërisë, vazhdimësisë dhe funksionalitetit, të cilat janë të nevojshme për operacionet e propozuara në kuadrin e një koncepti të veçantë të hapësirës ajrore. Ky koncept i ri paraqet një zhvendosje nga lundrimi ajror me sensor në lundrimin e bazuar në performancë. PBN është një ndër elementët kryesorë për zhvillimin e konceptit të hapësirës ajrore. Komunikimet, mbikëqyrja e Shërbimeve të Trafikut Ajror (SHTA) dhe Menaxhimi i Trafikut Ajror (MTA) janë gjithashtu elementë thelbësor të konceptit për hapësirën ajrore. Koncepti për PBN mbështetet në përdorimin e një sistemi zone navigacionale (RNAV ose RNP).


Dy janë komponentët thelbësor për zbatimin e PBN:

1. infrastruktura NAVAID;
2. specifikimet navigacionale;

Zbatimi i komponentëve të mësipërm në kontekstin e konceptit për hapësirën ajrore në rrugët e SHTA dhe procedurave instrumentale rezulton në një komponent të tretë, i cili është:

aplikacioni navigacional

Lundrimi ajror konvencional aktual NAVAID siguron fleksibilitet dizajni të kufizuar në përdorimin e hapësirës ajrore, ndërkohë kalimi nga lundrimi ajror i bazuar në sensor në lundrimin ajror të bazuar në performancë do të rrisë efikasitetin e hapësirës ajrore dhe optimizojë përdorimin e saj, siç tregohet më poshtë (fig.2).



RNAV përcaktohet si "një metodë lundrimi ajror e cila lejon operimin e avionëve në çdo rrugë ajrore të dëshiruar brenda mbulimit të stacion-referencës NAVAIDS ose brenda në kufijtë e mundësisë që kanë pajisjet, ose një kombinim i tyre". Kjo mënjanon kufizimin e vendosur nga

rrugët konvencionale dhe procedurat ku avionët duhet të fluturojnë duke ju referuar NAVAIDS, duke lejuar në këtë mënyrë efikasitet dhe fleksibilitet në operim. Në këtë kuadër, në datë 29.01.2012, u zhvillua në ambientet e shoqërisë Albcontrol SHA. një workshop në lidhje me planin e implementimit të PBN/RNAV STARs Tirana, të bazuara te sistemi satelitor i lundrimit global GNSS (Global Navigation Satellite System). Albcontrol SHA, në bashkëpunim me shoqërinë homologe Austro Control po punojnë për hartimin e procedurës së fluturimit RNAV STARs (Standart Arrival Procedure) në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës "Nënë Tereza". Për arsye të procedurave konvencionale të ngritjes dhe afërimit në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës "Nënë Tereza" mbështeten tek DVOR/DME, dalja e përkohshme nga operimi i këtyre mjeteve navigacionale sjell si pasojë vetëm mundësinë e operimeve vizuale për ngritjet - afërimit nga Tirana. Ky fakt mund shkaktojë vonesa të ndjeshme, deri anulim fluturimesh, nëse kushtet atmosferike nuk favorizojnë ngritjet/ mbërritjet vizuale. Përdorimi i RNAV SIDs/ STARs si procedura kontingjente në raste të tilla, do të evitonte pengesat apo bllokimet e mundshme të operimeve nga Aeroporti Ndërkombëtar të Tiranës "Nënë Tereza". Plani i implementimit të procedurave me PBN shtrihet përtej vitit 2020.

Implementimi i Procedurave për Lundrimin ajror të Bazuar në Performancë (PBN – Performance Based Navigation)

Ky plan orientohet duke analizuar ambientin lokal, Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës "Nënë Tereza" dhe Aeroportin Ndërkombëtar të Kukësit.

Albcontrol SHA do të ofrojë të gjitha të dhënat e nevojshme ekspertëve të Austro Control GmbH-së bashku me kufizimet për zonën e kontrolluar TMA të Tiranës, pengesat aeronautike, zonat ushtarake, aerodromet VFR, etj., të dhëna të rëndësishme për hartimin, dizajnimin e procedurës RNAV 1 STARs. I gjithë procesi do jetë në koordinim me Autoritetin e Aviacionit Civil (AAC), duke siguruar që çdo gjë do të jetë brenda kërkesave rregullative kombëtare dhe atyre Evropiane përpara publikimit të informacionit aeronautik në AIP Albania. Gjithashtu nga ana e drejtuesit të Aeroportit Ndërkombëtar të Kukësit, pati një prezantim për planin e futjes në operim të këtij aeroporti, ku u kërkuar konsulencë nga pala austriake në lidhje me procedurat e fluturimit, duke patur parasysh vështirësitë e terrenit të zonës. Për këtë arsye u vendos një vizitë pune në mjediset e Aeroportit Ndërkombëtar të Kukësit nga ekspertët për të krijuar një ide të terrenit përreth këtij aeroporti.

Përfitimet e Hapësirës Ajrore Shqiptare nga implementimi i PBN

Implementimi i PBN në hapësirën ajrore shqiptare do të sjell përfitime për të gjitha

palët e interesuara të përfshira në këtë proces: Republikën e Shqipërisë, përdoruesit e hapësirës ajrore, aeroportet dhe Albcontrol SHA. Përfitimet e parashikuara nga ky implementim janë si më poshtë:

Përfitime të përgjithshme:

- Standardizimin global të specifikimeve navigacionale. PBN dhe tranzicioni gradual drejt mjedisit të bazuar në GNSS është një nga shtyllat kryesore të konceptit të SESAR/ NextGen, e cila nga ana tjetër siguron arritjen e konceptit global të ICAO-s për ATM;
- Ndërveprim me rajone të tjera të ICAO-s dhe zonën e ECAC;
- Përfitime ekonomike: redukon nevojën për të mirëmbajtur rrugët dhe pajisjet me sensor specifik dhe kostot e lidhura me to;
- Siguron një proces miratimi operacional më të lehtë për operatorët, duke ofruar një grup të kufizuar specifikimesh navigacionale të cilat janë të destinuara për përdorim global;
- Përdorimi Fleksibël i Hapësirës Ajrore (FUA);
- Rritjen e kapacitetit të hapësirës ajrore.

Siguria ajrore (Safety):

- Rritjen e sigurisë ajrore;
- PBN siguron afrime të qëndrueshme, të stabilizuara në të gjitha skajet e pistës, e

cila sjell përfitim në rastin e një aeroporti të vogël si TIA duke përmirësuar afërimit me precizion;

- Përmirësimi i sigurisë ajrore (safety) duke siguruar rrugë fluturimi laterale dhe vertikale me precizion të lartë sipas Vlerësimit të Sigurisë APV Baro të EUROCONTROL (eliminimi gradual i afrimeve pa-precizion do të reduktojë mundësinë për CFIT);
- Mbërritja e avionit në pistë në linjë me vijën qendrore: konfigurim dhe shpejtësi e njëjtë në çdo kohë.

Mjedisi

- Nivelet e zhurmës do të reduktohen nëpërmjet përdorimit të profileve të optimizuara;
- Më pak impakt nga CO2 në mjedis. Zbatimi i operimeve të ngjitjes dhe zbritjes së vazhdueshme (CCO/CDO) nëpërmjet dekonfliktimit strategjik të flukseve të nisjeve dhe mbërritjeve do të reduktojë zhurmën dhe emetimet, duke siguruar kursimin e karburantit për përdoruesit e hapësirës ajrore;
- Përgatiti: DMSHLA

Air Albania merr nga EASA, autorizimin për operimet në transportin ajror tregtar

Gati dy vjet më parë tregut të kompanive ajrore ju bashkua kompania më e re kombëtare AIR ALBANIA. Tashmë ajo është rritur me më shumë destinacione në Evropë e më gjerë, personel dhe avion (Airbus A319-100 dhe Boeing 737-800).

Pas aplikimit në EASA – Agjencia Evropiane e Sigurisë Ajrore në Aviacion për marrjen e Autorizimit TCO përmes një procesi shumë rigoroz gjatë të cilit kontrollohen, evidentohen, shqyrtohen, vlerësohen në tërësi dhe me hollësi plotësimi i kërkesave teknike dhe procedurat administrative lidhur me operimet prej vendeve të treta, AIR ALBANIA u pajis më datë 8 Maj 2020 me Autorizimin CAT.

Ky Autorizim i lejon kompanisë të kryej fluturime tregtare ndërkombëtare në Shtetet Anëtare të BE, në 4 Shtetet e EFTAs (Bashkimi Evropian i Tregtisë së Lirë) Islandë, Lihtenshtejn, Norvegji dhe Zvicër dhe në territoret si Gjilbratari, Ishujt Alend, Azoret, Madeira, Ishujt Kanarie, Guadalupe, Guajana Franceze, Martinka, Reunion, Saint-Martin, Mayotte.

Urimet më të mira kompanisë flamur mbajtëse AIR ALBANIA.



- Tre avionë dhe një rrjet prej 26 destinacione në vitin 2020
- 15 destinacione të reja në tetë vende për dhe nga Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës

KOMPANIA AJRORE WIZZ AIR KRIJON BAZËN E RE TË AVIONËVE NË TIRANË

Wizz Air, linja më e madhe ajrore me kosto të ulët në Evropën Qendrore dhe Lindore, njoftoi me datë 29 maj 2020 bazën e re (home base) në Tiranë. Linja ajrore do të bazojë 3 avionë Airbus A320 në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës "Nënë Tereza", në korrik 2020. Së bashku me krijimin e bazës së re dhe ekzistencën e dhjetë destinacioneve tashmë në operim, Wizz Air njoftoi 15 destinacione të reja për tetë vende nga Tirana duke filluar nga korriku

2020, duke shënuar në total në 25 destinacione nga Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës "Nënë Tereza". Wizz Air njoftoi një sërë masash të përmirësuar të higjienës, për të siguruar shëndetin dhe sigurinë e klientëve dhe ekipazhit të saj. Si pjesë e këtyre protokolleve të reja, gjatë gjithë fluturimit, si ekipazhi i kabinës ashtu edhe pasagjerëve u kërkohet të mbajnë maska, ndërsa ekipazhi i kabinës gjithashtu u kërkohet të mbajnë doreza.

Njerëzit - Kapital i çmuar i AAC-së

Kohët e vështira na sjellin më shumë se kurrë në fokus rëndësinë e vlerave pozitive. Në në aviacionin civil me shumë se kush besojmë se njerëzit e trajnuar, me njohuri të thella dhe eksperiencë janë të rëndësishëm për të krijuar ekspertizën e domosdoshme në këtë sektor sa të rëndësishëm aq dhe kritik. Mbështetur mbi këtë filozofi, qasja jonë është ti bëjmë stafet tona të ndihen të sigurt, të respektuar duke besuar se vlerat pozitive janë ato që na çojnë përpara. Me dëshirën e sinqertë për të respektuar një kolege pune që për shumë vite me radhë punoj e kontribuoj në veprimtarinë e Autoritetit të Aviacionit Civil si Inspektore në sektorin e mbikëqyrjes së sigurisë ajrore në operim dhe duke respektuar masat e ruajtjes së shëndetit publik, disa ditë më parë, në sallën e mbledhjeve, u organizua një ceremoni e thjeshtë dhe shumë emocionuese mirënjohje me rastin e daljes në pension të Znj. Nedrete Mullaj. Znj. Nedrete ose Neti, siç e njohim ne të gjithë në AAC, ishte një kolege bashkëpunuese, e papërtuar dhe gojë ëmbël.

Duke përfutur nga ky rast i veçantë, stafi i AACs, i uron Netit tonë, ta shijojë pensionin si një kurorëzim të një rrugëtimi të gjatë pune e sakrificash!

Jetë të gjatë, plot shëndet e gëzime me familjes e miqve!

Stafi i AAC



E dhe gjatë muajit Maj 2020 Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës "Nënë Tereza" ka vazhduar të jetë i mbyllur për fluturime të rregullta ndërkombëtare civile tregtare si pasojë e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Ndërkaq në datat 01.05.2020 - 31.05.2020 siç është bërë e ditur nën kujdesin e qeverisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe në bashkëpunim me shoqërinë ajrore AIR ALBANIA kanë vazhduar operimet me kryerjen e fluturimeve të riatdhesimit të shtetasve shqiptarë që kishin mbetur jashtë vendit.

Nga dy aeroportet e Italisë (Romë dhe Milano) janë kryer 18 fluturime dhe janë transportuar rreth 3 200 pasagjerë;

Nga Gjermania, nëpërmjet aeroportit të Frankfurtit

janë kryer 6 fluturime dhe janë transportuar rreth 1100 pasagjerë; Po ashtu nga Britania e Madhe, Zvicra, Franca dhe Turqia janë transportuar gjithsej 1600 pasagjerë për në Shqipëri, nëpërmjet rrugës ajrore me avionët e shoqërisë AIR ALBANIA. Stafi i Sektorit për të Drejtat e Pasagjerëve (AAC) ka qene prezent në çdo moment dhe në përmbyshje të detyrave ka asistuar pasagjerët nëpërmjet telefonit, e-mail-it (pax@acaa.gov.al) dhe njoftimeve të rregullta në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit (www.aac.gov.al), me informacione dhe sqarime të nevojshme në këtë periudhë krize të shkaktuar nga COVID-19.

Për Sektorin e të Drejtave të Pasagjerëve

Përgatiti: Enkelejd Hajderi



Në këtë numër

BULETINI MUJOR MAJ 2020

- 1 AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL SHQIPTAR PËRBALLË SFIDAVE TË COVID-19
- 2 NJERËZIT - KAPITAL I ÇMUAR I AAC-SË
- 3 IMPLEMENTIMI I PROCEDURAVE PËR LUNDRIMIN AJROR TË BAZUAR NË PERFORMANCË
- 4 KOMPANIA AJRORE WIZZ AIR KRIJON BAZËN E RE TË AVIONËVE NË TIRANË

KONTAKT

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

ZYRA QËNDRORE
Rr. "Sulejman Delvina" P.O Box 205
Tiranë, Shqipëri
TEL.: +355 4 225 12 20
WEB: www.aac.gov.al
EMAIL: info@acaa.gov.al

Sektori Për Të Drejtat e Pasagjerit

TELEFON: +355 42 381 959
+355 44 539 959
EMAIL: pax@acaa.gov.al

Redaktori:

Z. BUJAR HAZIJAJ - Koordinator Për Të Drejtën Për Informim

EMAIL: Bujar.Hazijaj@acaa.gov.al

Media Sociale



facebook.com/AlbanianCAA



autoriteti.aviacionit.civil

Çdo tre orë pasagjerët problematikë kërcënojnë sigurinë tuaj ajrore. Shpërndaje këtë informacion nëse nuk dëshironi të fluturoni me ata! #notonmyflight

Fakte: Është keq dhe po shkon më keq.



Çdo tre orë siguria ajrore brenda BE kërcënohet nga pasagjerë që shfaqin probleme ose sjellje shqetësuese. Së paku 70% e këtyre incidenteve përfshijnë këtë formë të agresionit. Njëherë në muaj situata shkon në gradë të tillë, të uljes emergjente. Këto incidente kanë efekte direkt në sigurinë ajrore si të ekuipazhit ashtu dhe të pasagjerëve. Çdo lloj sjellje shqetësuese ose problematike pavarësisht se lidhet me dehjen, agresionin ose faktorë të tjerë paraqet një risk

të panevojshëm për operimin normal të një fluturimi.

Një person i dehur nuk do jetë në gjendje të ndjek udhëzimet e sigurisë ajrore kur ato nevojiten, sjellja agresive shmang ekuipazhin nga detyrat e tyre. Dhuna fizike rezulton në dëmtime dhe eksperiencë traumatike për çdo njeri në bord dhe nëse ndonjë pjesëtar i ekuipazhit dëmtohet, aftësia e tyre për të vepruar në raste emergjente, ulet

Çfarë është një sjellje problematike?

- Pija e tepërt alkoolike gjatë ose para fluturimit
- Përdorimi i drogës ose përzërja e tyre me alkoolin gjatë dhe para fluturimit
- Mos zbatimi i udhëzimeve të ekuipazhit
- Sjellja e dhunshme si verbale ashtu dhe fizike
- Çorientimi i ekuipazhit të kabinës nga detyrat e tyre



Është koha për të bërë diçka për të!

Çdo pasagjer dhe pjesëtar ekuipazhi ka të drejtë për një fluturim të sigurt, të lirë nga dhuna dhe sjelljet e tjera që mund ti vendos ata në risk. Udhëtimi duhet të jetë një eksperiencë e kënaqshme kur pasagjerët e trajtojnë njëri-tjetrin dhe ekuipazhin e kabinës me respektin që ata meritojnë.

Le ta ndalojmë këtë lloj sjellje menjëherë!

Së bashku me ju ne themi #notonmyflight.

